

VENDIM
Nr.33, datë 26.9. 2005

**MBI ANALIZËN E GJENDJES FINANCIARE TË SHOQËRISË
SË SIGURIMEVE “INSIG” SHA PËR VITIN 2004**

Në mbështetje të shkronjave “d”, “ë”, “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës së Sigurimeve”, nenit 93 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe të ligjit “Për kontabilitetin”, pasi shqyrtoi materialet e përgatitura nga organi ekzekutiv, në bashkëpunim me këshilltarin financiar të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, shoqërinë audituese ndërkombëtare Price Water House Coopers, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. T’i kërkohet shoqërisë së sigurimeve INSIG sh.a. të krijojë rezervën e sigurisë në vlerën 21 767 426 lekë që përbën 1/3 e fitimit të vitit ushtrimor 2004;

2. Shoqëria e sigurimeve INSIG sh.a. të bëjë provigjonimin e debitorëve në shumën 7 561 845 si më poshtë:

- | | |
|----------------------------------|-----------------|
| a) Debitore administrata | 4 166 983 lekë; |
| b) Debitore agjente për licencim | 3 394 862 lekë. |

3. Kërkesat e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi të pasqyrohen nga shoqëria e sigurimeve INSIG sh.a. në pasqyrat financiare deri në 31.12.2005.

4. Ngarkohet shoqëria e sigurimeve INSIG sh.a. dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 26.9.2005.

KRYETARE E KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba